

VENDIM
Nr.270, datë 6.4.2011

**PËR AKORDIM FONDI FINANCIAR SHITESË, BASHKISË VORË, PËR DHËNIE
NDIHME FINANCIARE FAMILJEVE TË DËMTUARA NGA AKSIDENTI
TEKNOLOGJIK I DATËS 15.3.2008 NË FSHATIN GËRDEC, PËR PAGESËN E
QIRAVE TË BANESAVE DHE TË DËMEVE TË SHKAKTUARA NGA
MOSPËRDORIMI I TOKAVE E KULTURAVE BUJQËSORE, QË NDODHEN BREND
PERIMETRIT 300 ML RRETH KRATERIT, ZONË E SHPALLUR SI ZONË E
SIGURISË SË LARTË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr.8756, datë 26.3.2001 “Për emergjencat civile”, të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe të ligjit nr.10 355, datë 2.12.2010 “Për buxhetin e vitit 2011”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Bashkisë Vorë, në buxhetin e vitit 2011, t’i akordohet fondi financiar shtesë prej 6 509 400 (gjashtë milionë e pesëqind e nëntë mijë e katërqind) lekësh, për dhënie ndihme financiare familjeve të dëmtuara nga aksidenti teknologjik i datës 15.3.2008 në fshatin Gërdec, për pagesën e qirave të banesave dhe të dëmeve të shkaktuara nga mospërdorimi i tokave e kulturave bujqësore, që ndodhen brenda perimetrit 300 ml rreth kraterit, zonë e shpallur si zonë e sigurisë së lartë.

2. Miratimin e listave të familjeve të bashkisë Vorë, së bashku me shumën përkatëse të kompensimit të dëmeve, sipas lidhjeve 1, 2, 3, bashkëlidhur këtij vendimi.

3. Fondi i akorduar, prej 6 509 400 (gjashtë milionë e pesëqind e nëntë mijë e katërqind) lekësh, të përballohet nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit.

4. Ngarkohen Ministri i Financave, Ministri i Brendshëm, prefekti i qarkut Tiranë, si dhe bashkia Vorë, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha